

## Martesa e fëmijëve

Martesa e hershme është shkelje mizore e të drejtave të njeriut dhe privon vajzat nga arsimimi, shëndeti dhe perspektiva afat-gjatë. Vajza që martohet në fëmijëri do të mbetet pa potencial të plotësuar. Pasi shumë prindër dhe komunitete kërkojnë më të mirën për fëmijët e tyre, ne duhet të punojmë së bashku në pengimin e martesave të hershme.

Dr. Babatunde Osotimehin, Drejtor Ekzekutiv i UNFPA-së

Nuk kishim zgjedhje tjetër. Familja ime dhe ajo e xhaxhait jetonim në një shtëpi të vogël. Ne duhet të largoheshim nga shtëpia sa më pare të ishte e mundur për shkak të hapësirës së pamjaftueshme. Kjo ishte arsyeja pse babai im më martoi.

– Bashkëshortja e moshës së mitur

### MARTESAT NË FËMIJËRI

Martesa e hershme ose martesa e fëmijëve është bashkimi zyrtar ose jo i dy personave, të paktën një prej të cilëve është nën 18 vjeç.<sup>1</sup> Fakti se ata janë fëmijë, na lë të kuptojmë se ata janë të paafte që si bashkëshortë të japin pëlqimin e lirë dhe të plotë të tyre dhe si pasojë martesat në fëmijëri janë shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve. Në Kosovë<sup>2</sup> sot, martesat e hershme janë relativisht të rralla, por vazhdojnë të jenë prezente dhe janë të zakonshme por jo edhe ekskluzive në disa komunitetet dhe/ose grupe etnike si në mesin e Romëve, Ashkalinjve, Egjiptianëve dhe Goranëve.

Martesa në fëmijëri është fenomen që prek djemtë dhe vajzat në forma të ndryshme. Marrë në përgjithësi, numri i djemve në martesat e hershme në botë është dukshëm më i ulët se i vajzave. Gjithashtu, dhuna në familje dhe abuzimi seksual është më i shprehur te vajzat. Nëse pason shtatzënia, kjo shpesh mund të përcillet me komplikime gjatë shtatzënisë dhe lindjes pasi trupi i vajzës nuk ka qenë i gatshëm për mbajtjen e shtatzënisë. Mjaft shpesh vjen deri te ndërprerja e e shkollimit për nevojë të punësimit te djemtë ose marrja e obligimeve shtëpiake nga ana e femrave me rastin e martesës.

Marrëveshjet, konventat dhe programet e ndryshme ndërkombëtare adresojnë martesat e hershme. Këtu përmendim: Konventa për Dhënien e Pëlqimit për Martesë më 1962, Moshë Minimale për Martesë dhe Regjistrimit të Martesave; Konventa e Eliminimit të të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979); Konventa e të drejtave të Fëmijut (1989), dhe; me 1995 Platforma për Aksion në Peking (e cila pasoi pas Konferencës së Katërt Botërore për gratë nga Kombet e Bashkuara). Instrumentet e tilla internacionale përfshijnë pengimin e traditave e zakoneve të dëmshme, dhunës ndaj vajzave, dhënia e pëlqimit në martesë, mosha për martesë, regjistrimi i martesave dhe liria e të zgjedhurit të bashkëshortit.

Këto të dhëna faktike ofrojnë informata për martesat e hershme në Kosovë duke dhënë rekomandimet për adresimin e kësaj çështje. Këtu janë të përfshira dhe revidimi i legjislacionit kombëtar dhe ratifikimi i standardeve të ndryshme relevante ndërkombëtare, analiza e zakoneve dhe qëndrimeve aktuale në çështjen e martesave të hershme si dhe të dhënat statistikore për prevalencën e kësaj dukurie. Metodologjia e këtij studimi ka inkorporuar revidimin e kornizës ligjore ekzistuese si dhe literaturës lidhur me martesat e hershme në Kosovë si dhe intervistat e bëra me 13 bashkëshortë të moshës fëmijërore dhe të nëntë ekspertëve në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe të grave.<sup>3</sup>

### REKOMANDIMET

- Revidimet e Ligjit Familjar duhet të qartësojnë: nëse fëmijët pas martesës kalojnë në adultë apo mbesin ende fëmijë; roli dhe mandati i Trupit Kujdestar në raport me martesat e hershme; si dhe procedurat ligjore dhe administrative përmes të cilave mirret vendimi për lejimin e martesës së një fëmije. Me këtë rast duhen marrë parasysh pengesat në qasjen për shërbimet e shëndetit riprodhues. Formimi i një mekanizmi multi-sektorial dhe involvimit të vendim-marrësve relevant do të siguronte mbrojtjen e të drejtave të minorenëve në martesat e hershme. Përmes këtij mekanizmi do të mundësohej vazhdimi i shkollimit të burrit dhe gruas duke ofruar këshilla rreth raporteve në martesë, të drejtat në pronësi dhe të drejtat e shëndetit riprodhues.
- Shkeljet në martesat e hershme të theksuara në Kodin Penal duhet të ndiqen penalisht *ex officio* (automatikisht); "tradita" nuk duhet të jetë arsyeja për justifikimin e mosarritjes së implementimit të kornizës ligjore ekzistuese.
- Ngritja e vetëdijes për të drejtat dhe opcionet për largimin nga marrëdhëniet violente shtëpiake duhet të ketë cak shoqërinë në kuptim të parandalimit të dhunës në shtëpi dhe në veçanti informata për ndihmë tu ofrohet të mbijetuarve nga dhuna.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet të krijojë procedura për sigurimin e vijimit të shkollimit të obliguar fillor dhe atij të mesëm të ulët. Kjo përfshin krijimin e procedurave të tilla mes vendim-marrësve relevant për monitorimin dhe raportimin e rasteve të braktisjes së mësimi, si atij të mundshëm ashtu dhe atij të vërtetë. Ndihamat sociale specifike për arsimim (p.sh transporti, veshmbathjet, librat) mund të reduktojnë braktisjen e shkollës, të inkurajojnë ndjekjen e mësimi nga ana e të varfërve dhe të ndihmojnë në parandalimin e martesës në fëmijëri sidomos në mesin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve.
- Enti Statistikor i Kosovës duhet të inkorporojë kategorinë e personave nën moshën 18 vjeçare në të gjitha të dhënat. Të dhënat e mbledhura duhet të jenë në dispozicion për analizë nga studiues të pavarur, nga hartuesit e politikave dhe institucionet tjera. Të dhënat

elektronike me informata të detajuara demografike duhet të jenë në dispozicion në tërë Kosovën përmes krijimit të databazave të unifikuara në ministritë dhe drejtoritë e punës dhe mirëqenies sociale, arsimit dhe shëndetësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë mënyrë do të mundësohet monitorimi i mirëfillt në parandalimin e martesave në fëmijëri dhe menaxhimi efektiv i rasteve.

- Koordinimi në mes të institucioneve (policia, shkolla dhe qendrat për punë sociale) duhet të jetë e specifikuar përmes memorandumeve të mirëkuptimit. Udhëzimet duhet të jenë të zhvilluara për institucionet relevante, duke sqaruar mandatin e tyre dhe çështjen e monitorimit dhe përgjegjësi referuese që kanë të bëjnë me martesat e hershme.
- Në pajtim me ligjin, MASHT gjithashtu duhet të përfshijë tema të caktuara në kurrikulën e shkollës të cilat do të japin informata të detajuara për shëndetin riprodhues, duke përfshirë kontracepcionin, planifikimin familjar dhe të drejtat riprodhuese.
- OJQ-të duhet të vazhdojnë me dhënjen e informatave përmes mediave dhe fokusi të jetë tek të rinjtë në komunitete ku dyshohet se martesat e hershme janë më të përhapura. Televizioni mund të jetë efektiv për komunikimin e informatave rreth të drejtave të grave dhe vajzave të cilat nuk kanë qasje në informata.
- Insitucionet relevante kanë obligim të sigurohen se: strehimoret për të mbijetuarit e dhunës në familje kanë fonde të mjaftueshme; struktura ligjore për mbrojtjen kundër dhunës në familje të implementohet; dhe të gjithë qytetarët të jenë të vetëdijshëm për drejtat e tyre dhe si të kërkojnë përkrahje, posaçërisht personat të cilët kanë hyrë në martesat e hershme dhe që mund të jenë posaçërisht të ndjeshëm ndaj dhunës por iu mungon informata për ndihmën në dispozicion.
- Shërbimet duhet të zhvillohen për të përkrahur fuqizimin ekonomik dhe re-integrimin e të mbijetuarve të dhunës në familje në shoqëri. Shërbimet e specializuara duhet të ndërtohen për të plotësuar nevojat specifike dhe të drejtat e fëmijëve të cilët shpesh janë dëshmitar të dhunës në familje.

### Rekomandimet (specifike për Rom, Ashkali dhe Egjiptian)

Të gjitha rekomandimet e përgjithshme janë relevante për Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Për më shumë, insitucionet relevante duhet të:

- Organizojnë aktivitete në ngritjen e vetëdijës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian duke diskutuar dhe kërkuar që; të ndrohen qëndrimet që kanë të bëjnë me praktikën e martesave të hershme; të inkurajohet edukimi dhe rritja e vetëdijës rreth strukturës eksistuese ligjore, posaçërisht në lidhje me të drejtat e grave dhe fëmijëve.
- Të bazohen në praktikën më të mira të Balkan Sunflowers për ndërhyrje dhe qendrave tjera lokale si qendra edukimi dhe informacioni për të rinjtë.
- Inkurajojnë familjet të përkrahin shkollimin e fëmijëve të tyre.

## KONTEKSTI LIGJOR DHE VENDOR

Si një nga vendet më të reja në botë, Kosova është duke u përpjekur të fuqizojë statusin e saj si shtet dhe të sigurojë njohjen zyrtare. Udhëheqësit politikë të Kosovës shpesh theksojnë angazhimin e tyre drejt integritimit evropian, përfshirjen e shoqërisë, të drejtat e njeriut dhe mundësitë të barabarta. Mirëpo, përkundër angazhimit të tillë "në letër", shpenzimet e shtetit të Kosovës ilustrojnë qartazi se prioriteti kryesor i qeverisë mbetet investimi në infrastrukturën e transportit. Kjo u ka kushtuar shtrenjtë shërbimeve sociale të Kosovës duke i lënë ato me fonde të pamjaftuara. Një gjë e tillë prek të gjithë qytetarët e në veçanti të martuarit në martesat e hershme. Pra, adresimi i kësaj çështje nuk është parë si prioritet nga ana e qeverisë por vlen të përmendim Asamblenë e Rinisë për Zhvillimin e Komunitetit e cila edhe ka identifikuar martesën e hershme si një problem.<sup>4</sup>

Të Drejtat e Fëmijës sigurojnë se mbrohen nga ligji por vetëm në letër e realiteti është ndryshe. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

partnerin e jetës<sup>5</sup>. Konventa e të Drejtave të Fëmijës dhe Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas bëjnë pjesë në Kushtetutë ndonëse Kosova nuk ka komitete të cilave mund t'u adresohet shkëlqja e këtyre të drejtave.<sup>6</sup> Kushtetuta e Kosovës ka dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Nisur nga aspiratat e saj drejt integritimit evropian, s'ka dyshim se Kosova ka interesin e saj të implementimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

## KUSH MUND TË KONTRAKTOJË NJË MARTESË?

Sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijës dhe Ligji për Familjen në Kosovë, fëmijë është personi nën moshën 18 vjeçare.<sup>7</sup> Mirëpo, Ligji për Familjen nuk është i qartë rreth faktit se pas martesë, fëmiju do të kalon në adult apo mbetet nën kujdesin e e prindërve të tij apo asaj gjer në moshën 18 vjeçare.

Martesat mund të bëhen vetëm me pëlqimin e plotë dhe të lirë të të dyja palëve dhe atë të bashkëshortëve me moshën mbi 18 vjet.<sup>8</sup> Megjithatë, gjykatat mund të lejojnë martesën e një të mituri mbi moshën 16 vjeçare nëse ai person ka arritur 'pjekurinë e duhur fizike dhe psikologjike' për ushtrimin e të drejtave martesore dhe përmbushjen e obligimeve martesore. Në raste të tilla, gjykatat duhet të kërkojnë të dhënat nga "Trupi Kujdestar", i mituri, prindërit e "tij", si dhe bashkëshorti i ardhshëm. Ligji nuk i definon qartë anëtarët e "Trupit Kujdestar" por ata interpretohen si prindërit e të miturit(ve).<sup>9</sup> Në rastet e martesës së hershme, vjen në pyetje brenga e prindit për të vendosur në interesin më të mirë të fëmijës. Të drejtat e fëmijës duket se janë të mbrojtura me ligj vetëm në letër.

## STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara apo e Këshillit të Evropës, shumë nga mekanizmat, ligjet dhe rregullativat ndërkombëtare vlejnë edhe në këtë vend. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e përfshirë në Kushtetutën e Kosovës, njeh të drejtën e dhënies së pëlqimit për martesë, ku pëlqimi nuk mund të jetë i "i lirë dhe i plotë" nëse njëra nga palët nuk është mjaft e pjekur dhe e informuar të merr vendimin për

Gjykatat mund të kërkojnë një ekzaminim mjeko-ligjor për të vendosur nëse i mituri është i pjekurisë adekuate për martesë. Pasi pëlqimi me shkrim për ekzaminimin e fëmijës nuk mund të ipet nga ana e fëmijëve nën moshën 18 vjeçare, mjeku ligjor duhet të ketë pëlqimin e prindit apo kujdestarit ligjor të fëmijës. Në realitet, ekzaminimet e tilla janë të rralla.<sup>10</sup>

Ligji për Familjen përmban rregullativën kundër martesës së detyruar, asaj nga kërcënim, gabimi ose "ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm".<sup>11</sup> Martesa e detyruar është e dënueshme me burg sipas Kodit Penal, si dhe kryerja e kësaj veprë ndaj fëmijës përfshin dënime edhe më të ashpra. Prindërit dhe kujdestarët ligjorë përballesh me dënime me burg së paku 15 vjet në rast detyrimi të një të mituri nën moshën 14 vjeçare për lidhjen e martesës. Prindërit ose kujdestarët gjithashtu përballesh me burgim për lejin e fëmijës për të bashkëjetuar me të rriturin, ndërsa të rriturit që jetojnë në "bashkësi jashtëmartesore" me të mitur të moshës 14-16 vjet mund të dënohen me burgim pesë deri në njëzet vjet.<sup>12</sup> Kodi Penal parashikon edhe dënime që variojnë nga gjopa në të holla deri në burgosjen për martesë të detyruar që rezultojnë në dobi materiale (p.sh. pagesën e pajës). Fitimet materiale që rezultojnë nga martesë e detyruar apo martesë e hershme gjithashtu mund të ndiqen penalisht sipas përcaktimit të Kodit Penal të trafikimit.<sup>13</sup>

## TË DREJTAT PËR PLANIFIKIM FAMILJAR DHE SHËNDETIN RIPRODHUES

Sipas Ligjit për Shëndetësinë, të gjithë qytetarët duhet të kenë qasje në kujdes shëndetësor si dhe t'u ofrohet siguri bazik dhe i obliguar shëndetësor.<sup>14</sup> Në institucionet publike shërbime të shumta duhet të ofrohen gratis. Ligji për Sigurimet Shëndetësore nuk është miratuar andaj të dhëna të detajuara rreth financimit të kujdesit shëndetësor për qytetarë mbeten ende të padefinuara. Të rinjtë dhe tinxherët si dhe "personat e marginalizuar" identifikohen si kategori speciale për të cilat Ministria e Shëndetësisë "ofron qasje në kujdesin shëndetësor riprodhues dhe seksual të nivelit më të lartë".<sup>15</sup> Individidët si dhe çiftet kanë të drejtë ligjore "për marrjen e lirë dhe me përgjegjësi të vendimit për numrin, shpeshësinë dhe kohën kur ata dëshirojnë të kenë fëmijë" dhe të kenë qasje në informatën që paraqet ndihmesë për vendimet e tyre.<sup>16</sup>

Gjatë vizitës në shërbimin shëndetësor, personat nën moshën 18 vjeçare duhet të jenë të shoqëruar nga përfaqësuesi i autorizuar. Pasi nuk është specifikuar nëse fëmijët pas martesës kalojnë në adultë, prezenca e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve nga

Gjenerata e vjetër mendon se është më mirë të martohen të reja para se të kenë probleme, si dashuria a shtatzënia. Ka rëndësi që ajo të jetë virgjine. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

Qendra për Punë Sociale mund të jetë e nevojshme me mundësi ndikimi në të drejtat e bashkëshortit të mitur për të vendosur për fillimin

dhe numrin e shtatzënive.<sup>17</sup> Intervistat sugjerojnë se disa nga prindërit e çiftetë të reja mund të involvohen në problemet e tyre të natyrës riprodhuese. Disa nga bashkëshortet e intervistuar kanë lindur qysh në moshën 15 vjeçare.

Ekspertët raportojnë se zhvillimi i pamjaftueshëm i organizmit të vajzave nën moshën 18 vjeçare për mbajtjen e shtatzënise dhe lindjes së fëmijut kanë ndikuar në shfaqjen e komplikimeve shëndetësore të ndryshme.

Sipas ligjit, të gjithë individëve u "garantohet e drejta në informimin dhe arsimimin për shëndetin riprodhues dhe seksual" por mënyra se si kjo mund të implementohet është e paqartë. Në klasën e shtatë (mosha 12 vjeçare) fëmijët mësojnë pak a shumë rreth pubertetit dhe ciklin menstrual. Anketa Demografike dhe e

Në atë moshë nuk kisha njohuri rreth planifikimit familjar dhe shtatzëni dhe e paplanifikuar. Ajo që mendoja ishte se: „Jam duke dalur me të dashurin tim. Unë e dua atë...“ Nuk kam ditur për ekzistimin e kontraceptivëve apo prezervativit pasi ndryshe nuk do të mbetesh shtatzënë dhe nuk do të isha martuar. Askush nuk më mësoi për këto gjëra. (Bashkëshortja e moshës së mitur)

Ekonomivë Shtëpiake e vitit 2009 flet se mbi 93% të femrave të moshës 15-19 vjeçare mund të përmendnin një metodë të kontracepcionit si dhe 88.8% prej tyre kishin njohuri për së paku njërin nga metodat moderne. Femrat e martuara ishin më të dijshe se ato të pamartuara.<sup>18</sup> Vetëm 8.8% njihnin efektin kontraceptiv të gjdhënies dhe vetëm 2.5% prej tyre kishin dëgjuar së voni ligjëratë rreth planifikimit familjar.<sup>19</sup> Me përmirësimin e informimit për kontracepcionin dhe shëndetin riprodhues mund të reduktohet numri i martesave të hershme të lidhura me rastet që kanë pasur shtatzëni të paplanifikuar. Të dhënat për planifikimin familjar janë gjeneruar së pari nga OJQ-të (51.7%) dhe mjekët familjarë (24.1%) por edhe nga institucionet religjioze (13.8%) dhe punëtorët social (6.9%). Këta akterë mund të paraqesin korrierë të rëndësishëm të të dhënave për të ardhmen. Shumë OJQ të ndryshme kanë pasur përpjekje për ngritjen e vetëdijes për shëndetin riprodhues por një punë e tillë është bërë në mënyrë sporadike dhe ka qenë e varur nga dhënia e donacioneve.

## MARTESAT E HERSHME NË KOSOVË

Në Kosovë, edhe pse nuk kemi të dhëna statistikore, në të kaluarën si duket ka qenë mjaft e shpeshtë martesë në moshë të hershme.<sup>20</sup> Deri në fund të shekullit 20të, kanë ekzistuar arsye të ndryshme politike, sociale dhe ekonomike për një martesë të hershme: të mundësojë emigrimin për qëllime evitimi të trazirave ekonomike dhe politike; për minimizimin e barrës për shpenzimet e prindërve (posaçërisht për vajzat që jetojnë në shtëpi shumë-anëtarëshe); për ofrimin e sigurisë ekonomike dhe fizike; dhe shkakut të jetëgjatësisë më të shkurtër.<sup>21</sup> Martesa e hershme është parë si një mënyrë e arritjes së një mënyre për parandalimin e dhunës seksuale, shmangies së çnderimit të mundshëm nga një shtatzëni të mundshme jashtëmartesore si dhe/ose ruajtja e mirëqenies përmes martesës në kushte më të mira ekonomike.<sup>22</sup> Në disa vende rurale dhe në mesin e disa Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve, vajzat e moshës së pubertetit 13-15 vjeçare janë konsideruar të gatshme për martesë.<sup>23</sup>

Të gjithë Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët duan të martohen me dikë jashtë Kosovës për një jetë më të mirë, shpesh në martesë të aranzhuara. Njoh shumë raste: kur vajza duket e gatshme në moshën 15-18 vjet, prindët e saj fillojnë të kontaktojnë njerëzit në Gjermani a diku tjetër. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

Të dhënat historike sugjerojnë për një rritje të martesës së hershme gjatë viteve të 90-ta, sidomos gjatë luftës më 1999.

Ju e dini se është më lehtë dhe më sigurtë kur jeni të martuar. Kohët kanë ndryshuar dhe s'mund t'i besohet askujt. Kështu une dhe burri im vendosëm të martohemi. (Bashkëshortja e moshës së mitur)

Prindërit besonin se martesat e tilla mund të mbrojnë vajzat e tyre.<sup>24</sup> Femrat e reja të përcaktuara si kryeshtëpiake shpresonin se martesë do t'u mundësonte kujdesin për motrën/vëllanë e tyre. Sa i perket femrave tjera të reja, kjo u siguronte vazhdimin e

lidhjes me të dashurit e tyre pasi ata emigronin.

Siguria në Kosovë është përmirësuar që nga viti 1999 andaj sot të rinjtë martohen në një moshë më të pjekur se para luftës.<sup>25</sup> Megjithate, moshë mesatare e martesës në vlerën 29.7 e regjistruar më 2011 duket e lartë. Një nga arsyet mund të jetë se në këtë mesatare janë përfshirë martesat e dyta ku bashkëshortët janë shpesh të moshës më të vjetër apo fakti se çiftet jo gjithmonë regjistrojnë martesat e tyre por i lënë për më vonë. Në shumë komunitete, krenimi me familje dhe shokë si dëshmitarë zakonisht është e mjaftueshme të konsiderohet si “martesë”. Kështu, më vonë në raste si lindja e fëmijës, udhëtimi i planifikuar jashtë shtetit etj regjistrohet martesë e tyre te autoritetet përkatëse.

Regjistrimi i menjëhershëm i martesave të hershme është shumë i rrallë. Së pari, ndëshkimi penal për prinderit, kujdestarët ose bashkëshortët e pjekur është një shkas që ata të evitojnë kontaktin me autoritetet sa i përket martesave të tilla. Dhe e dyta, procedurat administrative për martesë të ligjshme në moshën nën 18 dhe pagesat qoftë në gjykatë apo mjekësi ligjore marrin shumë kohë dhe janë të kushtueshme. Prandaj, ata zgjedhin të presin moshën 18 vjeçare për regjistrimin e kësaj martesë.

Në përgjithësi, 14 gjykata komunale kanë raportuar 116 kërkesa për martesë të hershme më 2010 dhe 107 të tilla më 2011.<sup>26</sup> Nuk

Kushërira imë është martuar si 17 vjeçare gjatë shkollës së mesme dhe menjëherë mbeti shtatzënë. Burri i saj nuk e lejoi as të shkollën në mbrëmjen e maturës pasi ai „e do“ dhe ajo duhet ta dëgjojë atë. Kjo është normale në Mitrovicë. Qëllimi jetësor i vajzës është martesë. Nuk është faji i tyre por i të gjithëve. Është kutia dhe ato ndodhen brenda kulisë. (Aktiviste e të drejtave të gruas)

ka pasur martesë të moshës 15 e mëposhtë të regjistruara në vitin 2010.<sup>27</sup> 108 rastet zyrtare të martesave të hershme më 2010 përfshijnë 0.59 % të të gjitha martesave ku të përfshira kanë qenë vajzat e moshës 16 e 17 vjeçare. Në mesin e djemve nuk ka pasur raste të regjistruara të martesave, por sidoqoftë gjatë intervistave për këtë

studim, janë identifikuar katër raste të martesave të hershme për djem të moshës 14-16 vjeçare. Në martesat e tilla, vajzat kanë qenë 5-10 vite më të reja se bashkëshortët e tyre.

Pra, martesat e hershme vazhdojnë të lidhen në Kosovë, sidomos në mesin e grupeve etnike të Romëve, Ashkalinjve, Egjiptianve dhe Goranëve edhe pse martesat e tilla lidhen edhe në grupe tjera etnike gjithashtu.<sup>28</sup> Martesa inter-etnike duket të jetë e rrallë ndërsa feja nuk duket të paraqesë faktor në këso lloj martesash.<sup>29</sup> Regjistrat publikë sugjerojnë se martesat e hershme janë më të shpeshta në Gjakovë, Pejë dhe Prizren edhe pse nga respondentët e intervistave është kuptuar se janë të zakonshme edhe në Mitrovicë.<sup>30</sup> Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët e rinj që jetojnë në kampe në Mitrovicën Veriore mund të shohin martesat e hershme si mënyrë për largimin nga kampi drejt “një jete më të mirë”.<sup>31</sup> Martesat e hershme janë të zakonshme edhe në vendet rurale ku ndikimi i traditës është më i fuqishëm.<sup>32</sup> Bashkëshortët e moshës së mitur kanë treguar gjatë intervistës se martesë e hershme është e shpeshtë në familjet dhe komunitetet e tyre.

Sot, arsyet e shtruar për martesë të hershme përfshijnë ato me dashuri, presionin nga familja, sigurinë, kushtet socio-ekonomike, shtatzënia e paplanifikuar, presioni nga bashkë-moshatarët dhe tradita.<sup>33</sup>

Pagesa e pajës (çejizit) nuk praktikohet më në mesin e shumicës së Shqiptarëve. Mirëpo, zakoni “baba hak” ku babai i dhëndrrit paguan babain e nuses, mbetet e shpeshtë tek Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët. Tradita si duket ka mbetur si mënyrë e financimit

*Bashkëshortet e mitura kishin arsye të ndryshme për futjen në martesë të hershme:*

Unë jam arratisur me të. Rashë në dashuri. Dëshiroja të isha me të prandaj ika.

Ata më thonin se kishte ardhur koha të marrohem. Nëse nuk marrohem tani, nuk do të mund të gjeja një partner të jetës. Nëna më thoshte se kështu edhe ajo ishte martuar. Pretendonin se nuk më shkonte shkolla, gjë që doli e vërtete prandaj „më mirë e ke të marrohesh“.

Babai deshi të më martojë me një burrë gjë për të cilën nuk e pyeti as nënën time.

Ishim pesë vajza dhe familja e kishte të vështirë të kujdesej për ne se ishin të papunë. Unë isha duke dalur me njërin dhe familja mori vesh për këtë dhe hapi tjetër mbeti martesë.

të shpenzimeve të martesës (p.sh. rrobat ose nata e kënasë ku gratë nga familja e nuses mbledhen të festojnë). Nuk është menduar të jetë një “pagesë për vajzën”.<sup>34</sup> Ndërsa shumica e paguar(nëse janë dhënë) dhe si shpenzohen të hollat, variron. Nga respondentët janë dhënë shifra prej 40-4000 €. Disa bashkëshorte të mitura kanë thënë se në martesën e tyre kanë pasur pajë.

Të shtunën e kaluar familja ime ka paguar €2000 për të martuar kushërirën time. Edhe pse kjo është jo e ligjshme, tradita vazhdon për shkak të të hollave. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

Respondentët ishin dakord që dispozitat ligjore që mbrojnë të drejtat e lartëpërmendura të fëmijëve, përfshirë dhe ato të martesës së hershme nuk implementohen në mënyrë të kënaqshme. Kur rastet e dyshuara të martesave të hershme hulumtohen nga autoritetet, liderët e komuniteteve mund të ndërhyjnë në negociimin mes policëve dhe prindërve.<sup>35</sup> Ndonjëherë, institucionet zgjedhin të mos jenë pjesë e këtij negociimi duke besuar se vendimi i takon familjes dhe bashkëshortëve. Përderisa përfaqësues të shumtë të institucioneve ia atribuojnë martesën e hershme traditës, aktivistët e të drejtave njerëzore luftojnë në ate se “nuk ka të bëjë aq me traditën por me dështimin e mekanizmave dhe institucioneve për implementimin e ligjit”. Shembuj të policëve, prokurorëve dhe gjykatësve të cilët justifikojnë mosveprimin e tyre duke ia përshkruar “shkakut të traditës”, ka pasur jo vetëm në rastin e martesave të hershme por edhe në raste të dhunës në familje.<sup>36</sup> Qendrat për Punë Sociale duhet të paraprijnë në mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijut.<sup>37</sup> Mirëpo, ato ballafaqohen me mungesë të madhe të fondeve, mungesë stafi dhe mungesë ekspertize.<sup>38</sup>

Pasojat e martesave të hershme përfshijnë dhunën në familje (përfshirë këtu dhe izolimin nga shokët dhe familja), divorcin, shtatzëninë e paplanifikuar, komplikimet gjatë shtatzënisë, ndërprerja e shkollimit dhe mosmundësia e qasjes në shanset e punësimit.<sup>39</sup> Bashkëshortet e mitura shpesh janë ekonomisht të varura nga familja e burrit dhe kanë një

Pasi u martua, gjithçka mori fund për të. Ajo lindi fëmijën e parë, të dytin, të tretin dhe ishte shumë e zënë me punë shtëpia. Edhe nëse dontë të dilte, ç’mund të bënte për këtë? Nuk ka shoqe. Nuk ka shkollë në fakultet. Nuk ka punuar kurrë. Ajo shkon vetëm te nëna e saj dhe kthehet në shtëpi. (Aktiviste e të drejtave të gruas)

fuqi të vogël vendim-marrëse brenda familjes ku burri dhe vjehrrin kanë fjalën kryesore. Kjo i vë ato në një pozitë edhe më të dobët dhe paraqet një fill të formave tjera të dhunës në familje.<sup>40</sup>

Martestat e hershme të aranzhuara me qëllim të mundësimit të emigrimit të fëmijut i cili ka lidhur kurorë, mund të vë fëmijun në rrezik të caktuar të izolimit.<sup>41</sup> Shkuarja në një vend me pak ose pa asnjë shok, pa anëtarë të familjes, strukturë mbështetëse ose mosnjohja e gjuhës i vë bashkëshortet e mitura në një pozitë të

Burri zakonisht s'mund të bashkëjetojë me femrat nga shteti i ri dhe mendon se vetëm kosovarja do t'i shërbejë si skllave. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

pasigurt dhe ato nuk kanë qasje në ndihmë. Martestat e aranzhuara me persona jashtë Kosovës nuk dalin gjithnjë siç edhe parashihen. Përderisa mashkujt që jetojnë jashtë Kosovës kanë mendimin se femrat ose vajzat Kosovare do të jenë të dëgjueshme dhe do t'i përvetësojnë rolet tradicionale gjinore brenda familjes, vajzat nga ana tjetër mund të shohin jetën jashtë Kosovës si një formë të ikjes nga tradita. Kështu përpjekjet në forcimin e dëgjueshmërisë mund të rezultojnë në dhunën në familje ndërsa mungesa e besimit mes bashkëshortëve mund të dërgojë drejt shkukurëzimit.

Shumë nga bashkëshortët në martesë të hershme raportuan të kenë përjetuar dhunë në familje "disa herë". Dhuna në familje ka

Ai më rrahu dy herë. Më kujtohet hera e parë ishte kur harrova t'ia mbush telefonin. (Bashkëshortja e moshës së mitur)

ndikim të madh në shëndetin fizik dhe psikik si dhe atë riprodhues. Kjo mund të nënkuptojë edhe gjakderdhjet e brendshme, lëndime të fetusit, abort dhe sterilitetin si pasojë apo dhe depresionin dhe frikën nga lidhjet në të ardhmen.<sup>42</sup> Personat që pësuan dhunën shpesh nuk u lejohet të shkojnë te mjeku, gjë e cila ndikon gjithashtu në shëndetin e tyre.<sup>43</sup>

## ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT

Të drejtat e barabarta të Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve janë të mbrojtura me ligj në Kosovë. Ligji kundër Diskriminimit ndalon çdo "diskriminim direkt ose indirekt" bazuar në etnicitet; gjuha Rome konsiderohet si gjuhë zyrtare në nivel komunal dhe Kosova ka strategjinë për integrimin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve.<sup>44</sup>

Vajzet Rome, Ashkali dhe Egjiptiane ballafaqohen me diskriminim të trefishtë: së pari në familje, në komunitetin e tyre dhe nga shteti i tyre. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

Të dhënat historike sugjerojnë se martesë në fëmijëri mbetet prevalente në mesin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve, ku disa lidhin martesë që në moshën 12 vjeçare. Në një Anketë më 2008 të 270 Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve, një e treta e tyre besonin se martesë e hershme mund të ndihmojë në lindjen e fëmijut të shëndoshë dhe 60% ndjenin se prindërit duhet të vendosin kush do të martohet me vajzën e tyre.<sup>45</sup>

Një i ri rom donte të martohet me një vajzë ndërkombëtare. Familja e tij ndërhyu dhe e martoi atë me me dhunë me një vajzë rome pasi s'donin ta martonin me një outsiders. Prindërit kanë rolin kryesor në familje dhe nuk duan ta ndryshojnë traditën. Tani ky ri i flet të njëjtën: "Duhej të ndërroja për shkak të presionit nga shoqëria". Është e vështirë të jesh delja e zezë në komunitetin tënd. (Përfaqësuesi i OJQ-së së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

Përfaqësues të OJQ-ve ishin dakord se arsimimi do t'u ofronte mundësi tjera pos martesës dhe njohuri më të mira të të drejtave. Poashtu, nëse të rinjtë do të vazhdonin shkollimin, kishin gjasa më të vogla për t'u martuar. Autoritetet nuk kanë vepruar sa duhet në inkurajimin e shkollimit, sipas respondentëve. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për fuqizimin e shkollimit të obliguar deri në moshën 15 vjeçare ose kryerja e klasës së 9-të.<sup>46</sup> Mirëpo, ligji nuk është i qartë rreth asaj se cili institucion do të monitorojë këtë dhe të zbatojë ligjin.

## INTERVENIMI TE MARTESA E HERSHME

Janë identifikuar vetëm dy nga iniciativat e qeverisë për martesat në fëmijëri: Këshilltari për barazi gjinore në Ministrinë e Pushtetit Lokal ka publikuar broshura rreth kësaj teme si dhe Agjensioni për Barazi Gjinore në zyrën e Kryeministrit dhe UNFPA kanë financuar një film të prodhuar nga Rjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane (RROGRAEK) më 2012 për martesat në fëmijëri. RROGRAEK transmetoi filmin në Radio Televizionin publik të Kosovës si dhe në komunitete të shumta, të përcjellura me diskutime. Asambleja Rinore ka organizuar evenimente për ngritjen e vetëdijes për disa nxënës të shkollave të mesme dhe prindërit e tyre me temën e martesës në fëmijëri.<sup>47</sup>

Balkan Sunflowers, një OJQ që punon me komunitetin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve në vende të ndryshme, inkurajon fëmijët në vazhdimin e shkollimit të tyre. Përmes debateve ata nxisin mendimin kritik rreth zakoneve e traditave si pagesa e pajës. Qendrat e tyre Mësimore në dhjetë komunitetet kanë programet parashkollore, mësimin të gjuhës, arsimit dhe shkolla për vajzat përmes të cilave synojnë të ndryshojnë normat ekzistuese për gjini dhe të ndikojnë në shkaqet e martesës në fëmijëri. Sipas një studimi së voni është vërejtur se ndërmjetësit e OJQ-së kanë kontribuar në rritjen e përfshirjes së popullatës me suksese të korrura në fushën e arsimit në komunitetet që i kanë pasur cak.

## PIKAT KYÇE (GJENERALIET)

Martesa e hershmë nuk është prioritet i qeverisë, veçanërisht në krahasim me sfida tjera si papunësia.

Të dhënat janë të pamjaftueshme dhe të pasakta. Të dhënat statistikore sociale dhe shëndetësore nuk mirëmbahen dhe nuk kanë qasje publike. Të dhënat e tilla janë vendimtare për hartimin e politikave sidomos në parandalimin e kësaj dukurie.

Mekanizmat e fuqizimit të moshës së caktuar me ligj nuk janë zhvilluar kështu dhe institucionet që mund të kenë rol të rëndësishëm në parandalimin dhe mbrojtjen e përgjegjësive të tyre s'do të kishin nevojë të përdorin "traditën" si justifikim.

Martesa e hershme shpesh rezulton në ndërprerjen e shkollimit që ndikon në statusin e punësimit në të ardhmen dhe rrjedhimisht kontribuon në varshmërinë nga ndihmat sociale.

Në martesat e hershme vajzat kanë fuqi shumë të vogël në vendim-marrje brenda familjes.

Ligji në Familje është i paqartë nëse fëmiju kalon në një adult pas martesës ose mbetet nën kujdesin e prindërve të tij deri në moshën 18 vjeçare. Prandaj, prindërit ose kujdestarët mund të mohojnë të drejtat për qasjen në kujdesin shëndetësor sidomos të natyrës riprodhuese të bashkëshortëve në martesa të tilla të lidhura.

Shteti ka përgjegjësinë të sigurojë se personat që përjetojnë dhunë në familje do të mbrohen dhe do të kenë qasje në shërbimet adekuate.<sup>48</sup> Aktualisht, shumë femra nuk janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre andaj qeveria duhet të punojë edhe më shumë në ofrimin e mundësive alternative përkrähese për femrat.

## PIKAT KYÇE (SPECIFIKEPËR ROMË/ASHKALINJ/EGJIPTIANË)

Martesa e hershme mbetet ende prezente në mesin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve. Disa prindër pajtohen me këte bile edhe aranzhojnë martesa të tilla, përkundër faktit se ato dënohen me ligjin në fuqi në Kosovë.

Policia e Kosovës dhe prokurorët nuk jan gjithmonë me qëndrim pro ligjit, bile ia atribuojnë këtë dukuri normave të kulturës së tyre.

Vetëdija jo në nivel e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve për të drejtat e tyre të specifikuar në kornizën ligjore të Kosovës dërgon drejt vështirësive në implementimin e ligjeve në fuqi.

Zakoni i pagesës për pajë ose "baba hak" vazhdon të jetë prezent në mesin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve, përkundër faktit se legjislacioni në fuqi është kundër kësaj.

Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët ndërprejnë shkollimin më herët se grupet tjera etnike, gjë që ndikon në perspektivën e tyre për punësim dhe statusin socio-economik. Të rinjtë që kanë lënë shkollimin janë në rrezik më të lartë për lidhje të martesave të hershme; njëkohësisht, martesa e hershme është arsyeja kryesore për vajzat në veçanti të ndërprejnë shkollimin në moshë të re.

## CITIME

***Të drejtat e fëmijëve janë të mbrojtura me ligj vetëm në dokumente dhe jo në jetën e vërtetë.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***Kjo informatë është konfidenciale dhe nuk mund ta bëjmë publike.*** (Përfaqësuesi i Entit Statistikor të Kosovës)

***Ata nuk janë të martuar në dokumente. Shumë martesa nuk regjistrohen fare.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së)

***Kosova duhet të ketë buxhet [asistencë suplementare arsimore] në ndihmë familjes ashtu që fëmijët të mund të vazhdojnë shkollimin.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***Mund të shprehem sigurt se [martesa] nuk ishte çfarë e kam imagjinuar. Fëmijët janë një përgjegjësi e madhe. Gjithashtu duhen respektuar dëshirat e anëtarëve tjerë të familjes: vjehrrit, vjehrrës, kunatës. Jeta jote kalon në duart e tyre dhe bëjnë me të çfarë të dëshirojnë.*** (Bashkëshortja e moshës së mitur)

***Në martesat e hershme, prindërit vendosin për numrin e fëmijëve që do t'i ketë çifti.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së)

***Qeveria duhet të bëjë diçka në ndihmë të femrave që nuk duan të kthehen tek burri i tyre. Disa femra lënë burrin por nuk kanë se ku të shkojnë; familja e tyre nuk i pranon më. [Ato] duhet të kthehen tek bashkëshorti i tyre pasi nuk kanë zgjidhje tjetër.*** (Bashkëshortja e moshës së mitur)

## CITIME

***Vazhdon të ndodhë tërë kohën.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***Kisha një kushërirë e cila kishte vetëm 16 vjet. Ajo donte të martohej por prindërit e saj nuk e lejonin. [Ato] shkuan në polici. Mirëpo, policët zakonisht e pyesin vajzën, "Çka dëshiron ti?" Nëse ajo ka dëshirë të martohej, ata shkojnë edhe sipas ligjit në fuqi ajo duhet të vizitohet te mjeku [për t'u vlersuar nëse mund të martohej me ligj]*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***Komunitetet nuk i njohin ligjet prandaj edhe ato nuk implementohen nga ana e tyre.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***Kjo dukuri paraqet një problem të madh pasi meshkujt kanë në pronësi vajzat. Ndonjëherë ata mund ta detyrojnë atë të lutet apo të punojë për tua kthyer të hollat.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

***[Vajzat dhe] djemtë që martohej herët ndërprejnë shkollimin dhe fillojnë të punojnë por ata s'mund të gjejnë një punë të mirë. Kjo pastaj ndikon në jetën e tyre sociale dhe kualitetin e jetës.*** (Përfaqësuesi i OJQ-së Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve)

<b>Popullata totale(2011):</b>	1,733,872 (50.4 % meshkuj, 49.6 % femra)
<b>Madhësia mesatare e familjes (2011):</b>	5.88 anëtarë
<b>Jetëgjatësia e pritur në lindje (2011):</b>	69.65 vite
<b>Perqindja e popullatës nën 15 (2011):</b>	32 %
<b>Popull.nën shkallën e varfërisë (2009):</b>	34 % <sup>50</sup>
<b>Shkalla e papunësisë:</b>	48 % <sup>51</sup>
<b>Shkalla e alfabetizimit, moshë 15-24 (2009):</b>	94.8% (alfabetizimi tek femrat: 91.0 %; meshkujt: 96.0 %) <sup>52</sup>
<b>Shpenzimet shëndetësore për kokë banori/viti (2011):</b>	€51 <sup>53</sup>
<b>Grupet kryesore etnike(2009):</b>	88% Shqiptarë, 7% Serbë, 5% të tjerë (Boshnjak, Goranë, Romë, Ashkalinj, Egjiptianë, Turkë) <sup>54</sup>
<b>Religjionet kryesore(2009):</b>	94.7 % Muslimanë, 3.9% Ortodoks
<b>Gjuhët kryesore:</b>	Shqipe (zyrtare), Serbe (zyrtare), Boshnjake, Turke
<b>Numri i martesave më (2010):</b>	18,289
<b>Moshë mesatare e martesës (2009):</b>	29.7 vite (femrat 28, meshkujt 31) <sup>55</sup>
<b>Shkalla e fertile. Specifike për moshë,mosha 15-19</b>	9.9 <sup>56</sup>
<b>Shkalla totale e fertilitetit:</b>	2.03

## TË DHËNAT STATISTIKORE PËR MARTESAT E HERSHME

Grumbullimi i të dhënave në Kosovë është shumë i mangët sa i përket të gjitha të dhënave statistikore sociale e jo vetëm ato për martesat e hershme. Disa nga indikatorët as nuk përfshihen ose nuk kanë qasje publike: martesat e parë sipas moshës dhe gjinisë; lindjet e gjalla sipas statusit martesor të nënës; shkalla e shtatzënisë; shkalla e mortalitetit maternal; shkalla e aborteve; komplikimet shëndetësore maternale; dhe lindja e frytit të vdekur sipas moshës së nënës.<sup>57</sup> Përderisa disa nga të dhënat e tilla mbledhen për grup-moshat më të vjetra, Enti Statistikor i Kosovës nuk e përfshin gjithmonë edhe grup-moshën nën 20 vjeç në publikimet e veta. Të dhënat për martesat e ndara sipas etnicitetit, statusit socio-ekonomik dhe religjionit gjithashtu nuk i kishin në dispozicion.

Table 1 Martesat sipas gjinisë dhe moshës (2010)

Moshë (vite)	Femra	Meshkuj
14	0	0
15	0	0
16	17	0
17	91	0
TOTAL	108	0

Table 2 Martesat sipas moshës së nuses dhe dhëndrrit (2010)<sup>58, 59</sup>

Numri total i martesave më 2010	Moshë e nuses (në vite)		Moshë e dhëndrrit(në vite)	
	Nën 15	16-19	Nën 15	16-19
18289	0 (0%)	1451 (7.93%)	0 (0%)	161 (0.88%)

<sup>1</sup> Fëmiu është “çdo qenie njerëzore nën moshën 18 përveç kur sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, moshë madhore arrihet më parë”. United Nations Convention on the Rights of the Child (1989), at: <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm> (accessed 29 May 2012).

<sup>2</sup> Në këtë dokument do të përshkruajmë Kosovën si Kosova nën rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244.

<sup>3</sup> Përderisa të gjitha “bashkëshortet e mitura” janë martuar para moshës 18 vjeçare, shumica e të intervistuarave në Qershor-Korrik 2012 ishin të moshës 18-25 vjet.

<sup>4</sup> Asambleja Rinore (2005) *Asambletë Rinore për Zhvillimin e Komunitetit*, OSBE, Prishtinë, at: [http://mixha.com/youth/\\_other/booklet\\_eng.pdf](http://mixha.com/youth/_other/booklet_eng.pdf) (accessed 20 July 2012).

<sup>5</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008). Neni. 37 mbron të drejtën e lidhjes së martesës me vullnetin e lirë dhe një të drejtat e barabarta të bashkëshortëve në martesë dhe në shkurorëzim. [http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution\\_of.the.Republic.of.Kosovo.pdf](http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution_of.the.Republic.of.Kosovo.pdf) (accessed 28 July 2012).

<sup>6</sup> Ibid, Neni. 22. CEDAW, Neni. 16, deklaroi se “Fejesa dhe martesja e fëmijut nuk do të ketë ndikim ligjor dhe gjithë aksioni përshirë këtu edhe legjislacionin do të ndërmerret me qëllim të specifikimit të moshës minimale për martesë.”

<sup>7</sup> Ligji për Familjen i Kosovës (Nr. 2004/32). Neni. 3.2.

<sup>8</sup> Ligji për Familjen i Kosovës (Nr. 2004/32). Kapitulli II, Seksioni 2, Neni. 16.1-16.3.

<sup>9</sup> Neni. 6 deklaroi se do t'i involvojë një “grup ekspertësh” në nivelin komunal.

<sup>10</sup> Intervistat me ekspertët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve (2012).

<sup>11</sup> Seksioni 3, Neni. 18. Ligji për Barazi Gjinore (2004/2) përsërit se moshë e pjekur për martesë është ajo 18 vjeçare, pos nëse është specifikuar ndryshe diku tjetër (p.sh Ligji për Familjen) dhe martesja e detyruar “dënohet me ligj” (Kapitulli VII, Neni. 23).

<sup>12</sup> Kodi Penal i Kosovës (2008), Neni. 245. Kryesi dënohet me burgim prej pesë deri në njëzetë vjet nëse lidh martesë me fëmijun 14-16 vjeç dhe së paku 15 vite burgim për fëmijun nën 14 vjeç. Nëse kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim së paku pesë vjet. (Kodi Penal i Kosovës Neni. 246).

<sup>13</sup> Kodi Penal i Kosovës, Neni. 171, 6.1 deklaroi se të gjitha aktet si “dhënia ose marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit” paraqet trafikim.

<sup>14</sup> Ligji për Shëndetësi, Neni. 7.1 dhe 7.2.

<sup>15</sup> Ligji No. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Neni. 31.

<sup>16</sup> Ibid, Neni. 2 and 4.

<sup>17</sup> Ligji No. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, Neni. 2.

<sup>18</sup> Enti Statistikor i Kosovës (ESK) (2011) *Anketa Demografike Sociale dhe e Shëndetit Riprodhues në Kosovë, nëntor 2009*, ESK, Prishtinë, f. 40.

<sup>19</sup> Ibid., f. 48.

<sup>20</sup> Të dhënat statistikore nuk janë mbledhur në mënyrë të rregullt qysh nga regjistrimi i vitit 1981.

<sup>21</sup> Intervistat me ekspertët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve (2012).

<sup>22</sup> Swaine, Aisling and Feeny, Thomas (2004) “A Neglected Perspective: Adolescent Girls’ Experiences of the Kosovo Conflict of 1999”, in Boyden, Jo and de Berry, Joanna (eds.) *Children and Youth on the Frontline*, Berghahn Books, New York & Oxford, p. 76. Hulumtimi ka përfshirë intervistat me 40 femra të reja refugjate dhe të kthyer.

<sup>23</sup> UNICEF (2004) *Trafikimi i Fëmijëve në Kosovë*, UNICEF, Pristina, f.10, [http://www.unicef.org/kosovo/kosovo\\_media\\_pub\\_prot.009.04.pdf](http://www.unicef.org/kosovo/kosovo_media_pub_prot.009.04.pdf) (accessed on 20 July 2012). Gjithashtu dhe intervistat me ekspertët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve (2012).

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> Të dhënat statistikore nuk janë në dispozicion.

<sup>26</sup> Të dhënat janë kërkuar nga çdo gjykatë pasi nuk ekziston sistemi i centralizuar i regjistrimit të të dhënave (Korrik 2012). Kosova ka 25 gjykata komunale edhe pse vetëm 20 prej tyre janë duke funksionuar.

<sup>27</sup> ESK (2010) *Wedlock Statistics*, ESK, Prishtinë, f. 16.

<sup>28</sup> Intervistat (2012). US Departmenti i Shtetit (2012) *2011 Raporti i te Drejtave të Njeriut: Kosovë*, <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/index.htm?dliid=186368> (accessed 24 September 2012). ) Raporti i Asamblesë Rinore për Zhvillimin e Komunitetit deklaroi se është e rrallë por vazhdon të ndodhë. Aktivistja Gorane e të drejtave të grave komentoi për mbi 10-12 martesat të hershme të lidhura në komunën e Dragashit cdo vit. Vetëm disa nga këto martesat përfshijnë edhe emigrimin, tha ajo. Të dhënat nuk i kishim në dispozicion.

<sup>29</sup> Shembull ku respondent theksoi se martesat e hershme lidhet në mesin e romëve në tërë Evropën Juglindore, duke involvuar persona të feve të ndryshme (intervistë me përfaqësuesin e OJQ-se Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve, 2012).

<sup>30</sup> Tre nga respondentët që punonin në OJQ të ndryshme e që janë aktive në komuna të ndryshme në mënyrë të pavarur përmendën Mitrovicën si regjion ku lidhen martesat e hershme (intervistat 2012).

<sup>31</sup> Intervista me përfaqësuesin e OJQ-se Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve (2012).

<sup>32</sup> World Bank (2005) *Kosovo Poverty Assessment*, World Bank, Washington, D.C., p. 64, at: [http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Country%20Home/20662049/Kosovo\\_PA\\_report\\_final-16June2005.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Country%20Home/20662049/Kosovo_PA_report_final-16June2005.pdf) (accessed on 20 July 2012).

<sup>33</sup> Shih: Swaine and Feeny (2004), *op. cit.*; USAID and EQUIP (2006) *Youth and Conflict: A Brief Review of Available Literature*, EQUIP, Washington, D.C. at: [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PNADT380.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADT380.pdf), (accessed 22 July 2012); UNFPA (2005) *Gender-based violence in Kosovo*, at: [http://www.unfpa.org/women/docs/gbv\\_kosovo.pdf](http://www.unfpa.org/women/docs/gbv_kosovo.pdf) (accessed 20 July 2012); and UNICEF (2004), *op. cit.*

<sup>34</sup> Intervistat me përfaqësuesit e OJQ-ve (Korrik 2012).

<sup>35</sup> Intervista me përfaqësuesin e OJQ-se Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianve (Korrik 2012)

<sup>36</sup> Intervistat (Korrik 2012). Shih, UNICEF (2004), *op. cit.*, f. 11.

<sup>37</sup> Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjes (2005).

<sup>38</sup> Shih Kosova Women’s Network (KWN) (2009) *More Than “Words on Paper?” The Response of Justice Providers to Domestic*



*Violence in Kosovo*, KWN, Pristina, at: [http://www.womensnetwork.org/images/pdf/Women's\\_Network\\_eng.pdf](http://www.womensnetwork.org/images/pdf/Women's_Network_eng.pdf) (accessed 27 July 2012), and KWN (2008a) *Security Begins at Home: Research to Inform the First National Strategy and Action Plan against Domestic Violence in Kosovo*, KWN, Pristina, at: <http://www.womensnetwork.org/images/pdf/shqip/tjera/security%20begins%20at%20home.pdf> (accessed 27 July 2012).

<sup>39</sup> Intervistat (July 2012). Shih edhe te UNICEF (2004), *op. cit.*; Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë (MASHT), ESK, UNICEF (2002) *Gender Review of Education in Kosovo*, MEST, Pristina; World Bank (2005) *Kosovo Poverty Assessment*, World Bank, Pristina, p. vi, at: [http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Country%20Home/20662049/Kosovo\\_PA\\_report\\_final-16June2005.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Country%20Home/20662049/Kosovo_PA_report_final-16June2005.pdf) (accessed on 22 July 2012). Nga 1453 divorce të raportuara më 2010, asnjë nuk përfshin ata nën moshën 15 vjet. Dy burra dhe 45 gra (1.6%) ishin nën moshën 20 vjeçare por tre nga të intervistuarat treguan se janë divorcuar nga bashkëshorti i tyre.

<sup>40</sup> Bashkëshortët e mitur, sidomos vajzat e reja thanë se nuk kishin fuqi vendim-marrëse në shtëpi. Shih edhe KWN (2008a), *op. cit.*

<sup>41</sup> UNICEF (2012) 'Summary Report on the Mapping and Assessment of the Child Protection System in Kosovo', UNICEF Kosovo, Pristina.

<sup>42</sup> KWN (2008b) Exploratory Research on the Impact of Gender-based Violence on Reproductive Health, KWN, Pristina, pp. 35-37.

<sup>43</sup> *Ibid.*

<sup>44</sup> Ligji i Anti-Diskriminimit (Nr. 2004/3), Neni. 2; Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni. 5 (Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët kanë vendin e tyre të garantuar në parlament sidhe një vend shtesë për grupin etnik me vota më të shumta, në total katër vende në parlament (Neni. 64.2)), dhe; Zyra e Kryeministrit (2008) Plani i Aksionit për Strategjinë e Integritimit të Komunitetit Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian në Kosovë 2009-2015.

<sup>45</sup> Mostra e volitshme nga 270 gra të moshës 16 e më lart nga Gjakova, Peja, Graçanica, dhe Fushe Kosova nga Qendra e Studimeve Gjinore dhe RROGRAEK ka zbuluar se 41% të tyre "kurrë" nuk kanë folur më shokët dhe 15% tregonin rrallë gjë që sugjeron për izolim. Shumica e tyre (61%) besonin se dhuna në familje ekziston në komunitetin e tyre por vetëm 36% kishin njohuri për shërbimet për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunën. Afro një e katërta e tyre kishte shëndetin e dobët dhe shumë të ligë. Të dhënat e tilla mund të mos jenë reprezentative për Kosovën si tërësi pasi nuk përfshijnë Mitrovicën dhe zona tjera ku Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptian jetojnë.

<sup>46</sup> Shkollimi i obliguar perfundon në fund të klasës së nëntë apo kur femiu mbush 15 vjet (varet cila vjen me heret) (Ligji Nr. 2002/2 UNMIK/REG/2002/19 Official Gazette 31 October 2002).

<sup>47</sup> Asamblete e Rinisë për Komunitetin (2005), f. 11.

<sup>48</sup> *Programi kundër dhunës në familje dhe Plani i Aksionit*, 2011.

<sup>49</sup> Pos kur është dhënë shënimi, të gjitha të dhënat në këtë seksion rrjedhin nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK) (2011) *Të dhënat Preliminare të Regjistrimit*

<sup>50</sup> World Bank (2011) *Poverty Consumption in Kosovo in 2009*, World Bank, Pristina. Vlerwsi mw 2009 ka gjetur shkallen e Varferise €46.50 per muaj.

<sup>51</sup> World Bank (2010) *Country Economic Memorandum*, World Bank, Pristina. At: [worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo\\_Poverty\\_for\\_web\\_eng.pdf](http://worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo_Poverty_for_web_eng.pdf) (accessed on 25 July 2012).

<sup>52</sup> UNDP, *MDG 2: Achieve Universal Primary Education, Progress Report*. At: [http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/MDG\\_2.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/MDG_2.pdf) (accessed on 25 July 2012).

<sup>53</sup> *Kosove Ligji për Buxhetin 2012* (2012) dhe ESK (2011) *Rezultatet Preliminare të Regjistrimit* (€88,588,425 / 1,733, 872 banore).

<sup>54</sup> Ramiz Ulaj, Drita Sylejmani, Kumrije Beqiri (2011) *Kosova në shifra 2010*, Ministria e Administratës Publike, Prishtine, f. 10, në: [http://esk.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat\\_view/36-general-statistics](http://esk.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/36-general-statistics) (accessed on 25 July 2012).

<sup>55</sup> ESK (2011) *Gratë dhe Burrat në Kosovë 2010*, f. 5, në: [http://esk.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat\\_view/8-population-statistics](http://esk.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/8-population-statistics) (accessed 25 July 2012).

<sup>56</sup> Enti Statistikor i Kosovës (ESK) (2011) *Anketa Demografike Sociale dhe e Shëndetit Riprodhues në Kosovë, nëntor 2009*, ESK, Prishtinë, f. 30

<sup>57</sup> *Biseda me përfaqësues të ESK* (2012).

<sup>58</sup> ESK (2010) *Wedlock Statistics*, p. 16.

<sup>59</sup> *Ibid*, p. 18.

## MESAZHET KRYESORE

Kur një vajzë martohet në një moshë më të pjekur, përfitojnë të gjithë. Vajza që martohet në moshë më të vjetër, ka gjasa më të mëdha të mos nderpresë shkollimin apo punën dhe të riinvestojë të ardhurat e saj në familjen e saj. Dhe që është më kryesorja, ajo do të jetë më e fuqishme në marrjen e vendimit të saj nëse dëshiron të bëhet me fëmijë dhe kur dhe sa fëmijë do t'i ketë. Investimet e bëra në vajza do t'i kthehen të gjithëve si familjes së tyre, komunitetit dhe ajo që është me e rëndësishmja vetë vajzës.

Do të na kushtojë shtrenjtë mosveprimi në rastet e martesave të hershme. Është koha që hartuesit e politikave, deputetët, komunitetet, familjet dhe të rinjtë të adresojnë këtë çështje për ta ecur para. Le të punojmë për një botë ku cdo shtatzëni është e dëshiruar, cdo lindje është e sigurtë dhe të përmbushet potenciali i cdo të riu. Lejoni që vajzat të mbesin vajza.

Martesa e hershme shkel të drejtat e vajzave, i privon ato nga fëmijëria e tyre, ndërpre shkollimin e tyre, rrezikon shëndetin e tyre dhe kufizon mundësitë e tyre në jetë. Nuk ekziston asnjë shpjegim i arsyeshëm nga aspekti kulturor, religjioz ose ekonomik për martesat e hershme i cili do të justifikonte dëmin e shkaktuar këtyre vajzave të reja. Vajzat duhet të kenë të drejtë të zgjedhin me kë do të martohen dhe kur do të martohen. Prindërit duan më të mirën për fëmijët e tyre andaj duhet t'i mbështesin ato në zgjedhjen e tyre dhe në marrjen e vendimit për lidhjen e martesës.

UNFPA është duke punuar me qeveritë dhe partnerë tjerë të të gjitha niveleve të shoqërisë për përpilimin e programeve gjithëpërfshirëse të cilat adresojnë nevojat e vajzave të martuara të pambrojtura dhe duke ofruar qasjen në mundësitë e mbështetjes për jetesë, mbështetjes sociale dhe shëndetësore, duke përfshirë programet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Qëllimi përfundimtar është që të vijë deri te pengimi i martesave të hershme të kësaj gjenerate dhe të ndryshohen pikëpamjet kulturore me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të vajzave.

## ÇFARË DUHET TË BËHET PËR TË THYER HESHTJEN PËR MARTESAT E HERSHME?

Të theksojmë vëmendjen ndaj situatave me të cilat ballafaqohen vajzat e martuara dhe vajzat në rrezik për lidhjen e martesës së hershme dhe të avokojmë më fuqishëm për të drejtat e tyre. Martesa e hershme nuk është e shëndetshme për vajzat as zhvillimin në përgjithësi. Nuk i konvenon askujt të përjetojë cdo ditë shkëlqen e të drejtave, rrezikimin e shëndetit dhe kapaciteteve të vajzave të reja.

Promovoni investimet në ndërtimin e aftësive dhe shkathtësive të vajzave adoleshente posacërisht në arsimimin e tyre. Arsimiti i vajzave, sidomos post-primar dhe të mesëm është faktori më i rëndësishëm i vetëm që ndërlidhet me moshën e lidhjes së martesës. Vajzat në vecanti kanë nevojë për përkrahjen e shoqërisë dhe qasjen në programe që ofrojnë shkathësitë për jetë, arsimim, jetesë dhe informacionet për shëndetin seksual dhe riprodhues dhe shërbime të tilla si planifikimi familjar dhe shërbimeve shëndetësore për shpëtimin e jetës së nënës.

## INVESTONI NË VAJZAT ADOLESHENTE!

Investimet duhet të sigurojnë platforma për vajzat e pambrojtura për të zhvilluar aftësitë për jetë dhe njohuri themelore shëndetësore, të kenë qasje në shërbimet sociale, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe në parandalimin e HIV-it,

të fitojnë aftësi profesionale dhe ato të nevojshme për punësim, si dhe të kenë afersi me miqtë e tyre dhe mësimdhënesit.

Vajzat e martuara kanë nevojë për strategji të veçantë që si shënjestër kanë qasjen në arsimim, aftësitë për jetë, kujdes shëndetësor duke përfshirë atë seksual dhe riprodhues dhe parandalimin e HIV-it si dhe mundësitë për t'u inkuadruar plotësisht në shoqëri. Programet maternale shëndetësore duhet të riorientohen duke i kushtuar rëndësi qasjes për të rinjte, nënat që lindin për herë të parë, për t'u mundësuar atyre të shfrytëzojnë shërbimet e kujdesit antenatal, emergjente obstetrike dhe shërbimeve që ofrohen pas lindjes së fëmijut.

## FALËNDERIMET DHE KONTAKTI ME NE

Këto të dhëna faktike janë pjesë e iniciativës së UNFPA-së në eliminimin e martesave të hershme. Është përgatitur nga Nicole Farnsworth për UNFPA-në. Ajo dëshiron të falënderojë personat si: Elmaze Gashi, Mimoza Pachuku, Ferdane Asllani, Bleta Smajli dhe Zana Rudi për ndihmën e tyre si hulumtuese si dhe organizatat: UNFPA, UNICEF, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, RROGRAEK, dhe Balkan Sunflowers për mbështetjen e tyre. Gjithashtu falënderimi shkon edhe për Damir Barisic, Lider Ekipi për Evropën Juglindore, Joanna Hoare, redaktore dhe Blanka Hancilova nga UNFPA EECARO. UNFPA EECARO dëshiron të faleminderojë Menhu Wang dhe Tulin Bas, praktikantë me UNFPA/EECARO për përkrahjen e tyre në finalizimin e këtyre të dhënave faktike.

Deklaratë: Qëndrimet në këtë publikim nuk janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e UNFPA-së, Kombeve të Bashkuara apo organizatave tjera simotra.

Kontaktet: UNFPA Kosovë: Mujo Ulqinaku No. 7, Pristina 10000, Kosovo; [nimani@unfpa.org](mailto:nimani@unfpa.org)

UNFPA EECARO: Hakki Yeten Caddesi, Selenium Plaza, No:10/C Kat 18-19, 34349 Besiktas, Istanbul, Turkey; [eecaro@unfpa.org](mailto:eecaro@unfpa.org)

Nëntor 2012, Version 1



Ndërtimi i një bote ku çdo shtatzëni është e dëshiruar, çdo lindje është e sigurt dhe potenciali i çdo të riu është i plotësuar.